“Jepjani pjesën e trashëgimisë atyre që u takon, e ajo që tepron, i përket mashkullit më të afërt.”

Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Jepjani pjesën e trashëgimisë atyre që u takon, e ajo që tepron, i përket mashkullit më të afërt.”
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith i urdhëron ata që merren me ndarjen e trashëgimisë që ta shpërndajnë atë tek ata që e meritojnë, në mënyrë të drejtë dhe sipas ligjit fetar, ashtu siç e ka caktuar Allahu i Lartësuar. Përfituesve të pjesëve të caktuara u jepen pjesët e tyre të përmendura në Librin e Allahut, të cilat janë: dy të tretat, një e treta, një e gjashta, gjysma, një e katërta dhe një e teta. Ajo që mbetet pas tyre, u jepet më të afërmve të të vdekurit nga meshkujt, të cilët quhen "asabe".

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5887

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY
لجنة الدعوة الإلكترونية
EDC E-Da'wah Committee